



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Ahmetog

V E N D I M

Nr. 613, datë 20.10.2021

P Ë R

PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT
DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTEA (PALLAT),
NË BASHKINË Durrës

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 561 411 457 (pesëqind e gjashtëdhjetë e një milionë e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në Bashkinë Durrës.
2. Fondi i rindërtimit për financimin e riforcimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, për vitin 2021, të jetë në masën 112 282 291 (njëqind e dymbëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një) lekë.
3. Efekti financiar, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të

projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe t'i kalojë Bashkisë Durrës, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ